



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Kamenicës / Opština Kamenice / Municipality of Kamenica

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Datë: 14/03/2025

Mbështetur në nenin:12 paragrafi 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr.04/2017, mbi Financimin Publik të OJQ-ve, si dhe Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve , me nr. 31251 – 09/2022, Drejtoria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE ARTISTIKE NË HAPËSIRA PUBLIKE

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Kamenicës shpall thirrjen publike për mbështetje financiare të projekteve artistike me qëllim të pasurimit të hapësirave publike me vepra arti. Ky program synon të inkurajojë krijimtarinë artistike dhe të integrojë artin në jetën e përditshme të qytetarëve, duke e bërë atë më të qasshëm dhe të dukshëm për publikun e gjerë.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të mbështesë krijimin e veprave të reja artistike që transformojnë hapësirat publike në ambiente më dinamike, atraktive dhe të frymëzuara nga arti. Përmes kësaj nisme, synohet promovimi i diversitetit kulturor, forcimi i komunitetit artistik dhe krijimi i një lidhjeje më të ngushtë mes artit dhe shoqërisë.

Kush mund të aplikojë?

Thirrja është e hapur për:

- ✚ Organizatat Joqeveritare (OJQ) që operojnë në fushën e kulturës dhe artit.
- ✚ Bizneset e regjistruara që mbështesin ose realizojnë projekte artistike.
- ✚ Artistë individualë me përvojë në krijimtarinë artistike vizuale dhe figurative.

Në kuadër të kësaj thirrjeje, mund të aplikoni për:

Krijimin e veprave të reja artistike publike, duke përfshirë skulptura, instalacione artistike, vepra abstrakte dhe projekte të tjera të artit vizual që pasurojnë hapësirat publike të Kamenicës.

Mbështetja financiare:

Fondi total: 12,000 €

Shuma minimale për projekt: 550 €

Shuma maksimale për projekt: 6,000 €

Kriteret e aplikimit:

- ✚ Aplikantët duhet të jenë të regjistruar dhe aktivë në sektorin e kulturës dhe artit.
- ✚ Nuk duhet të kenë përfunduar pa raportim projektet e financuara më parë nga Komuna e Kamenicës.
- ✚ Nuk duhet të kenë financim të dyfishtë për të njëjtin projekt nga burime të tjera.

🚩 Projekti duhet të ketë ndikim të qartë dhe të matshëm në hapësirat publike dhe komunitetin e Kamenicës.

🚩 Vepra artistike duhet të jetë origjinale dhe të respektojë vlerat kulturore të qytetit.

Afati i aplikimit:

Deri më 21 prill, 2025.

Afati i zbatimit (Përfundimit dhe vendosjes së veprës):

Maj - Gusht 2025.

Vendosja e veprave:

Veprat do të vendosen në rrethrotullimet e qytetit.

Dokumentacioni i nevojshëm

Për OJQ-të:

- Certifikata e regjistrimit dhe numri fiskal
- Vërtetimi i llogarisë bankare
- Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit
- Vërtetimi i detyrimeve tatimore

Për Bizneset:

- Certifikata e biznesit (NUID)
- Vërtetimi i llogarisë bankare
- Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit
- Vërtetimi i detyrimeve tatimore

Dokumente shtesë për të gjithë aplikantët:

- Portofoli i artistit/organizatorit
- Koncepti vizual i veprës
- Aplikacioni për projekt-program
- Formulari i buxhetit
- Deklarata e partneritetit (nëse ka)
- Deklarata mbi financimin e dyfishtë (nëse ka)

Dorëzimi i aplikimeve:

1. Aplikacionet e kompletuara me dokumentet e nevojshme dhe projekt propozimin sipas thirrjes publike mund të dorëzohen fizikisht në qendrën për shërbime për qytetar;
2. Përmes shërbimit postar në adresën e më poshtme:

KOMUNA E KAMENICËS

Rr. "Skënderbeu"

Objekti i Administratës Komunale

Qendra për Shërbim me Qytetarë

Vërjetje: Aplikantët duhet të sigurohen se aplikimi i tyre përmes shërbimeve postare, duhet të arrijë brenda afatit të paraparë në thirrje, në të kundërtën aplikimet që mbërrijnë jashtë kohës së thirrjes nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen te zyrtari përgjegjës **Azeminë Maliqi**, në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: azemine.maliqi@rks-gov.net, ose në numrin kontaktues 049 705 709 gjatë orarit të punës 08:00-16:00h (e hënë – e premte).

Drejtore

Behar Hyseni

